

As'habët e pyetën Pejgamberin a.s. se cilat vepra janë më të mirat? Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Të besosh në All-llahun dhe të pasosh rrugën e Pejgamberit të Tij, me këmbëngulje, t’i përmbahesh rrugës së përcaktuar nga All-llahu dhe të kryejsh haxh-xhin me sinqeritet (në emër të All-llahut xh. sh. e jo nga ambiciet e hipokrizisë).”*

Ebu Hurejreja transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Kush e kryen haxh-xhin dhe nuk gabon gjatë kryerjes së haxh-xhit pastrohet nga gjznahet sikur lindur prej nënës.”*

“Shpejtoni, kryenie haxh-xhin sepse askush nuk din se çka do ta pengojë sot apo nesër (të kryejë haxh-xhin).”

Historiku i haxh-xhit

Haxh-xhi ka qenë dhe mbetet adhurim fetar, andaj ai i cili merr rugën për në Mekë, i kryen të gjitha vizitat e parapara sipas rregullave kur'anore dhe Sunnetit merr emrin e shenjtë **haxhi**. Mirëpo, njeriut shpeshherë i sillen mendime të ndryshme rreth ibadeteve, sidomos shtrohet pyetja: a thua se prej kur daton ky ibadet?

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetje, duhet të kthehemi shumë larg në historinë e njerëzimit. Për t’u përgjigjur pyetjes së parashtruar duhet ditur se prej kur ekziston shtëpia e shenjtë – Kabeja dhe se kush e ndërtoi së pari?

Sipas disa pohimeve të cilat janë më të vërteta, Qaben për herë të parë e ndërtoi Ademi a.s. – njeriu i parë në fytyrën e Tokës, e jo Ibrahimimi a.s. siç kanë trilluar të dhëna të pavërteta armiqtë e Islamit. Këtë pohon edhe ajeti kur'anor: **“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëz, është ajo në Bekke (Mekke), e uruar dhe udhërrëfyese e popujve.”** (Ali Imran: 96)

Sipas kësaj që thamë gjer më tani shihet se Qabeja është shtëpi e parë e ndërtuar në fytyrë të Tokës në të cilën është bërë ibadeti i pastër monoteist – Islam.

Pasi që Qabeja natyrisht, ka qenë pandërprerë e ekspozuar ndryshimeve klimatike, ajo ka përjetuar edhe disa meremetime. Kështu që, Kur’ani na e parashtron edhe rindërtimin e Qabes në kohën e Ibrahimimit a.s.

Ibrahimi a.s. ndërton Kaben

Ibrahimi, i urdhëruar nga All-llahu xh. sh. gruan e dytë Haxheren bashkë me djalin Ismailin u detyrua t'i dërgojë në vendin e Mekës së sotshme e cila atëbotë ende ishte e pabanuar. Konkretisht, i shtyer nga zilia bashkëshortore, Ibrahimi e la Haxheren bashkë me Ismailin në vend të panjohur, vend ku nuk kishte gjurmë jete.

Ibrahimi kthehet për në Palestinë, Haxhereja e pyet: “Në duar të kujt na lë!” Ibrahimit nga dëshprimi i lotojnë sytë, andaj nuk guxon ta shikojë gruan – Haxheren. Mirëpo, Haxhereja e tronditur nga ky qëndrim i Ibrahimit, përsëri e pyet: “Ku po na lë kështu?!” Ibrahimi nga dëshprimi nuk kthehet kah gruaja. Mirëpo, Haxhereja e pyet për herë të fundit duke u bindur se ky është urdhër i All-llahut xh. sh., andaj edhe i thotë: “Ibrahim, a Zoti të ka urdhëruar kështu?!” “Po!” – u përgjigj Ibrahimi. Atëherë Haxhereja shtoi: “Ai me siguri nuk do të na humbasë!” Ibrahimi tani më ndahet nga Haxhereja.

Haxhereja me djalin e vogël harxhoi ujin, ky ishte shkasi që të vrapoj prej kodrinës së Safasë e gjer në kodrinën e Mervës, vallë mos po sheh ndonjë njeri i cili do t'u ndihmonte. Kështu vrapoi shtatë herë. (Vrapimi i Haxheres njëherit sot në haxh-xh simbolizon sa'jin në mes safasë dhe Mervës.) All-llahu xh. sh. urdhëroi Xhibrilin të shtrijë krahun e tij dhe kështu buroi uji i Zem-zemit: “All-llahu nuk do të na humbasë.” – ishte e bindur Haxhereja.

Jeta kalon, Ismaili rritet. Ndërsa Ibrahimit në formë të inspimit i Shpallet se duhet të rindërtojë Kaben, tempullin e shenjtë të cilin e patë themeluar Ademi a.s. Andaj niset për në Mekë, vendi i Kabesë. Pasi përfundoi me punimet, i urdhëruar nga All-llahu xh. sh. tha:

وَأَذِّنْ فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ ﴿٢٧﴾

“Dhe ftoi njerëzit në haxhillëk, do të vijnë ata ty – në këmbë dhe (duke shaluar) në çfarëdo deve; duke ardhur prej të gjitha viseve të largëta.” (Kur'an, el-Haxhxh: 27.)

Thirrjes së Ibrahimit a.s. iu përgjigjën muslimanët e të gjitha kohërave. Mirëpo, njerëzit sa më tepër largoheshin nga rruga e drejtë – Islami, aq më tepër ndërronin mënyrën e ibadetit rreth tempullit të shenjtë. Kështu që gjatë etapave historike lirisht mund të themi se Qabenë herë e adhuronin sipas rregullave të përcaktuara nga All-llahu xh. sh. e herë devijonin nga rruga e drejtë, rezultat i së cilës ishte edhe adhurimi krejtë i gabuar rreth Qabesë. Këtë e vërtetojnë hadithet e Pejgamberit a.s. të cilat na japin të dhëna burimore

se arabët para se të shpallet Islami, tavafin Qabesë ia bënë në forma të ndryshme. Kështu vazhdoi deri sa Muhammedi a.s. dha formën e pastër të tavafit dhe të haxh-xhit.

Porositë e Haxh-xhit të Lamtumurës

Vitin e dhjetë vajti Pejgamberi a.s. në Mekë për të kryer detyrën e haxhillëkut, dhe para një numri të madhë muslimanësh në vendin e quajtur Mina mbajti një fjalim, i cili quhet: **“Fjalimi i Lamtumurës”**, sepse është fjalimi i fundit që mbajti në Mekë. Pejgamberi a.s. në mes tjerash në fjalimin e mbajtur tha:

“O popull, dëgjoni fjalët e mija mbasi nuk e di se a do të jetoj edhe një vit tjetër dhe se a do të jemë prap në mesin tuaj. Ta dini se jeta, pasuria dhe nderi i juaj janë të shenjëta për njëri tjetrin, sikurse është e shenjtë kjo ditë, ky muaj dhe ky vend, për të gjithë, gjer ditën kur do të dilni para Zotit! Dijeni me siguri se do të dilni para Tij dhe Ai do të kërkojë llogaritë e veprave që keni bërë. Kush të ketë ndonjë amanet le t’ia jap atij i ka besuar.

O popull, ju keni të drejta ndaj grave, dhe ato kanë të drejta ndaj jush. Silluni me gratë e juaja me mirësi dhe dashuri se jeni përgjegjës para Zotit për to.

Fajdeja (kamata) është e ndaluar. Borxhlinjtë le të kthejnë të hollat që kanë marrë hua. Së pari do të vihet në zbatim ky urdhër për të hollat që ka huazuar xhaxhai im Abasi djali i Abdul Mutalibit.

Arisokracia e injorancës është nën këmbët e mia. Arabi nuk është më i lartë nga ai që nuk është arab, dhe ai që nuk është arab nuk është më i lartë nga arabi. Të gjithë janë bijtë e Ademit dhe Ademi u krijua nga balta.

O popull, dëgjoni fjalët e mija dhe më kuptoni mirë. Dijeni se të tërë muslimanët janë vëllezër, janë një familje. Asnjëri prej tyre nuk duhet të marrë pasurin e tjetrit pa lejen e të zotit. Keni kujdes dhe ruheni nga padrejtësia.

Shërbëtorëve dhe robërve të luftës jepnu të hanë nga ajo që hani ju. T’i vishni me të njejtat roba me të cilat visheni ju vetë. Po të bëjnë ndonjë gabim u dhuroni lirinë. Ata janë shërbëtorët e All-llahut e nuk duhet të përdoren keq.

*O popull, unë po ju lë juve dy gjëra, gjersa do t’i zbatoni ato, do të jeni në fitim. Ato janë: **Libri i All-llahut dhe udhëzimet e Pejgamberit të Tij.***

Ata që janë këtu, le t’ua përcjellin këshillat e mija atyre që nuk i dëgjuan. Në mes të tyre mund të gjenden njerëz që mbase do t’i kuptojnë këshillat e mija

edhe më mirë se ata që i dëgjuan. O ju të mbledhur! A ju kam shfaqur Mesazhin Hyjnor?”

Ledina e Minasë gjëmoi nga zëri i fortë që doli nga gojët e të pranishmëve:
“Sigurisht, po, ti e ke dhënë **Mesazhin Hyjnor**”.

Nga kënaqësia ndriti dhe shkëlqeu fytyra e Pejgamberit a.s. sytë iu mbushën me lot gëzimi dhe mirënjohjeje dhe duke ngritur duart lartë tha:

“O Zot! Le të jesh dëshmitarë se e plotësova misionin që ma ngarkove.”

Në ndërkoh All-llahu xh. sh. i shpalli edhe ajetin kur’anor me të cilin kuptoi se haxhi i këtij viti ishte me të vërtetë lamtumirës për Muhammedin a.s. në ajetin kur’anor thuhet:

...الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا...

“...Sot ua përsosa dispozitat e fesë suaj dhe ua plotësova dhuntinë Time ndaj jush. Jam i kënaqur që feja islame të jetë fé e juaja...” (el-Maide: 3)

Fjalimin e Muhammedit a.s. nëse e analizojmë pikë për pikë me siguri nuk do të mjaftonte një libër voluminoz që të përfshijë qëllimin e porosive, por për këtë rast do të mjaftojmë me sa vijon:

“Arabi nuk është më i lartë nga ai që nuk është arab...” Pejgamberi a.s. vë në pah barazinë njerëzore pa marrë parasyshë gjuhën, racën dhe vendin ku jeton muslimani, sepse për muslimanin apsulisht feja është, çështja primare e cila njëherit i tejkalon të gjitha kufinjët apo përkufizimet të cilat i mendoj njeriu më vonë për qëllime të këqija dhe njëanëshe.

“Silluni me gratë e juaja me mirësi dhe dashuri se jeni përgjegjës para Zotit për to.” Feja e vetme e cila i dha vendin e merituar gruas në shoqëri pamëdyshje është Islami. Këtë e shohim edhe në porositë e fundit të Pejgamberit a.s.. Gruaja nuk është më robëreshë të cilën duhet eksploatuar gjer në pikën e fundit dhe vetëm në të mirë të burrit. Asaj më nuk i takon vetëm një ditë në vit (tetë marsi), përkundrazi edhe asaj i takon i tërë viti sikur burrit. Andaj, shoqatat bashkëkohore të formuara në Perëndim, me një herë panë gabimet që i bënë për një kohë të shkurtër me vetë themelimin e atyre shoqatatve. Në fund ato deklarojnë vet (Kryetarja e shoqatës së grave të Francës, përmes shtypit pat dhënë këtë deklaratë) se të drejtat e gruas mund t’i gjejnë vetëm në Islam e assesi në shoqatat e formuara më kot.

“O popull unë po ju lë juve dy gjëra...Librin e All-llahut dhe Sunnetin tim...”
Shpëtimi i vetëm për muslimanin është t’i përmbahet Kur’anit dhe Hadithit të

Pejgamberit a.s. Sa më tepër të largohemi nga këto dy burime aq më tepër do të shkatërrohemi si bashkësi. Kjo kuptohet nga ana e kundërt e porosisë së Pejgamberit a.s. shkatërrimin do ta keni në shtëpi, në familje, mes bashkëshortëve, në rrugë, në xhami etj.

Pra, nuk mbetet tjetër vetëm se t'i kthehemi Kur'anit dhe Hadithit, dy burimeve të All-llahut xh. sh. nëse duam të shpëtojmë në këtë botë dhe në botën tjetër. Aminë.

(Përkthimi I Fjalimit të Lamtumirës është marrë nga libri: “Muhammedi profeti Islam” Imam Vehbi Ismaili, Prishtinë 1985.)